



Prioritetet e Këshillave Lokal

Projekti: “Qytetari aktive dhe komuna përgjegjëse në Kosovë”

Organizata joqeveritare Syri i Vizionit nga Peja, në kuadër të projektit “Qytetari aktive dhe komuna përgjegjëse në Kosovë” ka mbajtur takime me kryetarët e këshillave lokal në gjashtë (6) komuna ku ky projekt shtrihet: Rahovec, Gjakovë, Deçan, Klinë, Istog dhe Pejë.

Qëllimi i këtyre takimeve me kryetarët e këshillave lokal ishte radhitja e prioriteteve, tri (3) deri në pesë (5) me të rëndësishmeve për lokalitetin e tyre, në mënyrë që komunat në investimet e tyre kapitale dhe planifikimet buxhetore për vitin 2023 t’i përfshijnë këto prioritete duke ndikuar në përmirësimin e drejtpërdrejtë të kushteve të jetesës dhe mirëqenien e banorëve dhe rritur transparencën e investimet me përfshirjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve.

Duhet theksuar se në takimin me kryetarët e këshillave lokal nuk kanë marrë pjesë të gjithë kryetarët, pavarësisht ftesave të dërguara me kohë dhe mundësisë së ofruar që prioritetet e tyre t’i adresojnë tek ne edhe me shkrim.

Prioritetet e dala nga takimi me kryetarët e këshillave lokal në komunën e Rahovecit janë si më poshtë:

Prioritet e këshillave lokal të dala nga pjesëmarrësit në takim

Këshilli lokal Qytet

Lagja “Halil Hamza”

1. Asfaltimi i rrugës me një gjatësi prej 1 kilometri dhe gjerësi prej 4 metrash
2. Ndërrimi i gypave të kanalizimit duke vendosur gypa më të gjerë
3. Mirëmbajtja e terreneve sportive në lagje dhe shkollë dhe këndeve të lodrave.

Lagja II “Mustafë Cena”

1. Rregullimi i varrezave të 38 martirëve të luftës dhe dëshmorëve
2. Ndërtimi i sistemit të kanalizimit në ndërtesat kolektive diku 300 metra - Rruga “Xhevat Elshani”
3. Ndërtimi i një objekti inovativ dhe shkollës së muzikës përballë policisë.

Xërxë

1. Ndërtimi i një shkolle të re, pasi shkolla e vjetër nuk plotëson kushtet për numër nxënësve
2. Sigurimi apo përcaktimi i lokacionit të ri për varreza së paku 2 hektarë
3. Rregullimi i rrugës dalëse “Rrustem Kryeziu” mbi 400 metra nga rruga kryesore deri tek Drini dhe të bëhet rrugë publike
4. Rregullimi i shtratit të Përroit diku 300 metra gjatësi pasi çdo vit ka humbje të tokës punuese dhe rrezikon shtëpitë e “Lagjes së Epërme”
5. Riparimi i sistemit të kanalizimit për ujëra të zeza në “Lagjen e Epërme”, pasi që rrjeti ekzistues nuk është funksional dhe ka një gjatësi prej diku 2 kilometrash.

Fortesë

1. Zgjerimi dhe thellimi i shtratit të Përroit prej hyrjes deri në dalje të fshatit diku 2 kilometra
2. Rregullimi i rrugës “Kodra e Trimave” me gjatësi diku 600 metra
3. Përfshirja në rrjetin e kanalizimit të “Lagjes së Gashve” dhe lagjes tjetër.

Hoçë e Vogël

1. Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit për ujërat e zeza në Lagjen “Hoti” ku janë mbi 20 shtëpi e të cilat ende nuk janë të kyçura në rrjetin e kanalizimit
2. Riparimi i rrjetit të kanalizimit me një gjatësi prej 1 kilometri
3. Largimi i mbeturinave të ngurta në rrugën “Zona Operative e Pashtrikut”
4. Mirëmbajtja e terrenit sportiv tek “Bregu”

5. Rregullimi i rrugëve fushore - saktësisht dy rrugë: “Luan Krasniqi” dhe rruga e “Parakatunit”
6. Kubëzimi i 10 rrugicave të fshatit që kanë një gjatësi prej 900 metrash.

Dejë

1. Riparimi i kanalizimit i ujërave të zeza në tërë fshatin
2. Hapja dhe betonimi i kanaleve për ujerat atmosferike nga hyrja e fshatit deri tek Drini.

Pataqan i Epërm

1. Ndërtimi i kanalizimit për dy lagjet apo rrugën njëra në “Saki Bellaqa” dhe tjetra “Istikamet e UÇK-së” me një gjatësi prej diku 1.5 kilometrash
2. Kubëzimi i dy rrugëve në lagjet “Sakipi” dhe “Rruga e Bajraktarit” me një gjatësi prej 300 metrash
3. Ndriçimi i fshatit pasi rrezikohet jeta e banorëve e sidomos e fëmijëve gjatë kthimit nga shkolla në ndërrimin e pasdites
4. Ndërtimi i terrenit sportiv në shkollën “Saki Bellaqa”
5. Ndërtimi i trotuareve për këmbësorë përgjatë rrugës kryesore
6. Rregullimi dhe betonimi i shtratit të lumit i cili kalon përmes fshatit me një gjatësi prej 600-700 metrash.

Dobidol

1. Rregullimi i kanaleve për ujëra atmosferike me një gjatësi prej 1 kilometri që fillon nga rruga kryesore deri tek hekurudha - në të dy anët e rrugës kryesore (magjistrale)
2. Rregullimi i kanalit të kullimit prej hekurudhës deri tek Drini me një gjatësi diku 1 kilometër
3. Riparimi i rrugëve të kubëzave dhe vazhdimi i ndërtimit të trotuareve për këmbësorë
4. Ndërtimi dhe rregullimi i rrethojës së shkollës fillore dhe të mesme të ulët “Rudolf Walther”
5. Ndërtimi i terrenit sportiv në shkollën fillore dhe të mesme të ulët “Rudolf Walther”.

Reti e Poshtme

1. Renovimi i shkollës fillore dhe të mesme të ulët “Haki Stërmilli”
2. Ndërtimi i parkut në hyrje të fshatit dhe rrethimi i tij
3. Rregullimi i gropës septike dhe riparimi i filtrave si dhe pastrimi i saj
4. Rregullimi i rrugëve fushore në gjatësi prej 3000 metrash.

Guri i Kuq

1. Ndërtimi i një grope septike për ujëra të zeza zonën perëndimore të fshatit
2. Kubëzimi i rrugës së varrezave të fshatit me një gjatësi prej 400 metrash

3. Rregullimi i rrugës fushore prej varrezave deri në fshatin Çifllak me një gjatësi prej 2 kilometrash
4. Mbjellja e 100 drurëve dekorativ përgjatë rrugës kryesore.

Çifllak

1. Renovimi i shkollës fillore dhe të mesme të ulët “Rilindja”
2. Kubëzimi i rrugëve të fshatit me një gjatësi prej 2500 metrash
3. Kubëzimi i rrugës nga ambulanta deri të varrezat – “Rruga e UÇK-së” diku 600 metra
4. Sanimi i dëmtimit të rrugës kryesore nga prerjet që janë bërë nga operatorët dhe individët për kyçje në rrjetin e kanalizimit duke filluar nga binarët në Xërxë deri në Kramovik, diku 1 kilometër gjatësi.

Sapniq

1. Rregullimi i rreth rrotullimit në Fortesë, Pataqan dhe Sapniq
2. Asfaltimi i rrugës që lidh varrezat e fshatit me Pataqanin e Ulët, diku 2.5 kilometra
3. Ndërtimi i trotuarit në fshatrat Sapniq dhe Fortesë përgjatë rrugës kryesore me një gjatësi prej 1.5 kilometrash
4. Blerja e një trafo të rrymës.

Ratkoc

1. Ndërtimi i segmenteve të reja të kanalizimit në lagjen e Ashkalinjve deri tek Drini
2. Ndërtimi i segmentit të ri të kanalizimit nga vendi “Isuf Hoti” deri në Malësi e Vogël.

Koment shtesë:

Banorët e disa fshatrave kanë bërë një peticion të cilin ia kanë dorëzuar KRMU “Radoniqi” për rregullimin e “Bajpasit” afër Urës së Fshajtë, i cili do të zgjidhte furnizimin e vazhdueshëm më ujë të pijshëm për banorët e kësaj zone.

Ky dokument është hartuar në kuadër të programit “Qytetari aktive dhe komuna përgjegjëse në Kosovë” i cili zbatohet nga Syri i Vizionit, Communication For Social Development, EC Ma Ndryshe dhe Democracy Plus që kanë lidhur aleancë për zbatim të këtij programi i cili mbështetet financiarisht nga Olof Palme International Center.

Komuna: Rahovec, shtator 2022